

Pamje ajrore e
nënkalimit rrugor të
ri në Dandenong.

Albanian

Rruga Webster, Dandenong, gusht 2026

Hapja e rrugës së re në Dandenong këtë shtator

Nënkalimi rrugor i ri në Dandenong, i cili lidh rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond do të hapet të martën më 22 shtator.

Nënkalimi rrugor i ri do të zvogëlojë mbingarkesën dhe do të ofrojë një rrjet rrugor më të besueshëm për Dandenong, duke u mundësuar shoferëve që të udhëtojnë drejtpërdrejt nga rrugët Hammond dhe Cheltenham në perëndim deri në një kryqëzim të ri të sinjalizuar në rrugën Princes Highway-Lonsdale në lindje.

Me një hapësirë prej 5.4 metrash, nënkalimi i ri krijon një rrugë të drejtpërdrejtë për kamionët dhe automjetet e larta, duke zvogëluar nevojën e tyre për të udhëtuar nëpër rrugët lokale dhe përmes qendrës së Dandenong-ut.

Nënkalimi rrugor i ri në Dandenong do të hapet më të martën, më 22 shtator, dy vjet para afatit të parashikuar.

Gjatë javëve të ardhshme do të përfundojmë punimet për të lidhur nënkalimin e ri me rrugët Princes Highway Lonsdale, Cheltenham dhe Hammond dhe do të kryejmë asfaltimin, shënimin e vijave në nënkalim dhe instalimin e sinjaleve rrugore në rrugën Princes Highway-Lonsdale.

Vitin e kaluar kemi mbyllur rrugën Webster te kalimi në nivel dhe kemi hapur një shteg të ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster në Rezervatin Woodcock, i cili lidhet me shtegun Dandenong Creek, duke lidhur vendasit me qendrën e Dandenongut.

Në pranverë do të instalohej vepra të reja arti përgjatë shtegut të ecjes dhe çiklizmit nën urën hekurudhore.

**LEVEL
CROSSING
REMOVAL
PROJECT**

Përfitimet e projektit



Përmirëson sigurinë, zvogëlon mbingarkesën dhe krijon një rrjet rrugor më të besueshëm për Dandenong-un



Devijon trafikun larg qendrës së Dandenong-ut



Mban kamionët larg rrugës Webster



Përgatit zonën për zhvillim në të ardhmen



Barrierat janë hequr në rrugën Webster, duke shkurtuar kohën e udhëtimit për 10.000 automjete



Regjistrohuni për përditësime
levelcrossings.vic.gov.au

**VICTORIA'S
BIG BUILD**

Ndryshimet në rrjetin rrugor të Dandenong-ut

Kur nënkalimi rrugor i ri të hapet të martën, më 22 shtator, do të ketë mënyra të reja për të lëvizur dhe ndryshime në mënyrën se si udhëtoni në Dandenong.



Pat Dow



Merle Mitchell AM

Nënkalimi i ri rrugor Cheltenham

Kur nënkalimi rrugor i ri të hapet, ai do të bëhet një zgjatim i rrugës Cheltenham.

Do të udhëtoni nga rrugët Cheltenham dhe Hammond në perëndim, nën linjën hekurudhore, deri në një kryqëzim të sinjalizuar në rrugën Princes Highway-Lonsdale në lindje.

Rruga Webster në lindje do të riemërohet Dow Court

Me rrugën Webster të mbyllur në linjën hekurudhore dhe linjat Cranbourne dhe Pakenham pa barriera, seksioni i rrugës në lindje të linjës hekurudhore do të riemërohet Dow Court për nder të Pat Dow.

Një pjesë e rrugës Cheltenham do të riemërohet Merle Parade

Kur të hapet nënkalimi i ri, në pjesën e rrugës Cheltenham Road mes rrugëve Foster dhe Hammond Road do të lejohet dalja vetëm majtas drejt rrugës së re. Ky seksion i rrugës Cheltenham do të riemërohet Merle Parade për nder të Merle Mitchell AM.

Për të lexuar më shumë rreth ndryshimeve në rrjetin rrugor të Dandenong-ut dhe emrat e rinj të rrugëve, skanoni kodin QR ose vizitoni

**levelcrossings.
vic.gov.au/
webster-travel-
changes-
factsheet**



Punime të mëdha në gusht dhe shtator

Gjatë javëve të ardhshme do të përfundojmë punimet në anën lindore dhe perëndimore të nënkalimit të ri për ta lidhur atë me rrugën Princes Highway-Lonsdale, Cheltenham dhe Hammond dhe do të instalojmë sinjalet rrugore në rrugën Princes Highway-Lonsdale

Për të përfunduar në mënyrë të sigurt punimet, rruga Cheltenham do të mbyllet midis rrugës Hammond dhe 1 Cheltenham Road nga **e hëna më 24 gusht deri të martën më 22 shtator.**



Do të ketë devijime gjatë këtyre punimeve Skanoni kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-major-road-works



Etapa përfundimtare në Dandenong

Kemi filluar Gërmimin e Madh në nëntor të vitit të kaluar dhe në qershor kemi përfunduar gërmimet të nënkalimit i ri.

Në korrik, kemi përfunduar derdhjen e betonit për bazamentin e rrugës së re, ku derdhja më e madhe ka arritur në 1,100 metra kub, mjaft për të mbushur afërsisht 11 autobusë. Në gusht kemi përfunduar muret e nënkalimit.

Për të parandaluar përmbytjet në nënkalim, kemi instaluar një sistem kullimi për të pompuar ujin jashtë dhe në një bazen akumulues, duke filtruar në mënyrë të natyrshme ujin para se të derdhet në përroin Dandenong.

Po bëjmë hapat e fundit në rrugën e re, duke përfshirë asfaltimin dhe shënimin e vijave, dhe po instalojmë ndriçimin dhe sinjalet rrugore.

Gjithashtu, po lyejmë muret e nënkalimit me pesë ngjyra të veçanta, për të pasqyruar karakterin e gjallë dhe shumëllojshmërinë e Dandenong-ut.

Ndërtimi në numra

Që nga fillimi i ndërtimit ne kemi:



gërmuar më shumë se **13** pishina olimpikë dhe kemi hedhur



mbi **11.000** metra kub beton



kemi vendosur **403** pilonë për të mbështetur muret e nënkalimit dhe urës së re hekurudhore



mbjellë mbi **15.000** pemë vendase, shkurre dhe barishte, dhe do të mbjellim akoma **15.000**



ndërtuar **9** bazamente betoni që shërbejnë si themel për nënkalimin



instaluar më shumë se **3.000** ton çelik për muret, bazamentet dhe pilonët e nënkalimit



Armaturimi i mureve të nënkalimit.



Derdhja e betonit për bazamentin e nënkalimit nën urën hekurudhore.

Përparimi i projektit në fotografi

Maj



Formësimi i mureve të stacionit të ri të pompimit në nënkalim, me pamje në perëndim drejt Cheltenham Road.



Pamja ajrore e nënkalimit rrugor të ri, me pamje në perëndim drejt Cheltenham Road.

Qershor



Ndërtimi i anës lindore të nënkalimit.



Këmbët mbështetëse të urës hekurudhore dhe hidroizolimi i bazamentit të nënkalimit.

Korrik



Montimi i mbajtëseve të përkohshme prej çeliku.



Mbështetëset e derdhura në të dyja anët e brezit ndarës të ri, me pamje nga lindja drejt rrugës Princes Highway-Lonsdale.



Pas barrierave

Zbuloni se çfarë po ndodh pas barrierave duke skanuar kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-galleries



Punimet janë në vazhdim, dyqanet janë të hapura



Rrugët Cheltenham dhe Hammond janë të hapura për biznes.

Blini produkte lokale dhe mbështesni bizneset lokale në rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Faleminderit që i mbështetni bizneset lokale në Dandenong ndërsa përgatitemi për të hapur nënkalimin e ri rrugor.



Shëndet dhe fitnes

- ReMAP Performance
- Iron Pigs Strength Club



Shërbime dhe automobilistikë

- Southside Carwash and Detailing
- Sky Thai Massage
- Sunrise Trailer Parts Dandenong
- Grand Autoworks & Tyre
- 4WD Suspension Store
- Raw Performance Imports
- Ram Cheapest Cars
- AAS Auto
- Hertz Car Rental
- Avis Car Rental
- Kian Auto Services
- Mega Trim
- ABW Trade
- Indesign Plastics + Displays
- Hyun Engines
- KMMotor Traders
- Wonder Motors
- J & V Elite Motors
- Mayani Automotive & Car Detailing
- Happy Car Sales
- Tyre Barn Dandenong
- Southeast Auto & Tyre
- Mike's Dyno Tuning



Ushqim dhe pije

- Silk Road afanti catering

FALEMINDERIT DANDENONG

Festim komunal falas

Për të falënderuar komunitetin për durimin gjatë punimeve të ndërtimit, po organizojmë një festim falas për komunitetin.



Bashkohuni me ne për të festuar dhe bëhuni i pari që kalon nëpër nënkalimin rrugor të ri.

Do të ketë kafe, ushqim, aktivitete familjare dhe për fëmijët, argëtim dhe shumë më shumë, gjithçka falas.

Skanoni kodin QR ose vizitoni: **levelcrossings.vic.gov.au/webster-community-event**

Ku: Në nënkalimin rrugor të ri dhe në Parkun Dandenong

Kur: Nga ora 12:00 deri në orën 15:00, E diel më 20 shtator



Qëndroni të informuar

Regjistrohuni për përditësime me email duke vizituar **levelcrossings.vic.gov.au/subscribe** dhe nën linjat **Cranbourne-Pakenham**, zgjidhni rrugën **Webster**, **Dandenong**.



Regjistrohuni për përditësime me SMS lidhur me heqjen e kalimit në nivel në rrugën Webster

Skanoni kodin QR ose dërgoni tekstin **WEBSTER** në numrin **0428 581 917**



Afati kohor i projektit



2018

- Projekti u njoftua



2022 deri në fund të vitit 2023

- Hetimet në terren, sondazhet e trafikut dhe punimet e planifikimit



Nëntor 2023

- Dizajnet konceptuale janë lëshuar
- Konsultimi me komunitetin
- Hetimet në terren vazhdojnë



Fundi i vitit 2024

- Dizajnet përfundimtare janë lëshuar
- Punimet e para



2025

- Fillon ndërtimi
- Hapet shtegu i ecjes dhe çiklizmit nën linjën hekurudhore
- Barrierat hiqen përgjithmonë
- Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel



2026

- Ndërtimi
- Nënkalimi rrugor i ri hapet të martën më 22 shtator
- Sistemimi i hapësirave të jashtme



2027

- Projekti përfundon

* Afatet kohore mund të ndryshojnë.



Na kontaktoni

Për më shumë informacion telefononi në **1800 105 105** ose shkruani në email **levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au**

levelcrossings.vic.gov.au

levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)     

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse kenë nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni **relayservice.gov.au**.

